

VENDIM
Nr.231, datë 7.4.2010

PËR DHËNIEN E NJË FONDI NDIHME PARTISË “TOLERANCA E RE E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë “Toleranca e Re e Shqipërisë” t’i jepet fondit prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit për vitin 2010.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha